



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 7757 prot

Roskovec, më 30.08.2022

VENDIM

NR 65. DATË 29.08.2022

“PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT

“HARTIMI I PROJEKTIT-PREVENTIVIT, ZBATIMIT PËR OBJEKTIN:

“REHABILITIMI URBAN I NJË PJESE TË BLOKUT NR.3 NË QËNDËR TË QYTETIT

ROSKOVEC (FAZA 1)”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”; të Ligjit Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, të ndryshuar; të VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

Të miratojë projektin me objekt :

1. **Hartimi i projektit-preventivit, zbatimit për objektin: “Rehabilitimi urban i një pjese të Bllokut nr.3 në qëndër të qytetit Roskovec(faza 1)”**
2. Projekti trajton aspektin urban të kësaj hapësire, bazuar në Projekt-idenë e miratuar. Ky bllok është një nga zonat më të banuara në qytet, por që mbart mjaft problematikë urbane dhe sociale. Qëllimi kryesor i këtij hartimi të këtij projekti është :

3. *“Rehabilitimi i një pjese të Bllokut nr.3 duke e kthyer në shërbim të qytetarëve për ti dhënë një pamje të re dhe funksionale qytetit duke u mbështetur në Strategjinë Territoriale të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Roskovec”.*
4. Në zgjedhjen e vendndodhjes dhe rehabilitimit urban i Bllokut nr. 3 përfshin projektin e fushës së sportit duke kthyer të stadiumit me shkallë me kapacitet **1500-2000** vende, krijimin e parkut të ri të qytetit, ndërtimin e Postës së re të Policisë, Sistemimin kanalit kullues në lindje të stadiumit ndërtimi i rrugës lidhëse me asfaltobeton trotuar dhe ndricim rrugor. Për realizimin e projektit kompania ekzistuese është njohur me informacionin e nevojshëm ekzistues lidhur me të dhënat që kërkon projekti sipas detyrës së projektimit e cila është hartuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.
5. Kjo detyrë projektimi do të përmbajë këto nënobjekte
 - 5.1 *Ndërtimi i fushës së sportit me njësi tregëtare*
 - 5.2 *Ndërtimi i parkut të ri të qytetit*
 - 5.3 *Sistemimi i kanalit kullues dhe ndërtimi i rrugës lidhëse mbi të*
 - 5.4 *Ndërtimi i Postës së re të Policisë (Projekt ekzistues i miratuar nga Bashkia Roskovec)*

Do të rikualifikohet një pjesë e Bllokut nr. 3 e cila do ti jap një pamje të re qytetit. Stadium me standarte të FIFA-s hapsira të reja të gjelbërta për qytetin , rrugë me standarte Europiane dhe një godinë të dedikuar postës së re së Policisë.

Projekti zhvillimor i këtij blloku do të kushtëzojë gjithë zhvillimin e aktivitetit urban, përmirësimin e gjendjes së rrugëve, të infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore, të prishjeve të objekteve ekzistuese, shpronësimeve dhe ndërtimeve të reja, të ndërtimit të ambienteve çlodhëse për fëmijë e të rritur dhe një pjesë te mirë të reduktimit të ndikimeve negative për ambientin përreth.

6.Vlera totale e projektit: 833 333 lekë pa tvsh.

7.Burimi i financimit të këtij projekti : Buxheti i Bashkisë

8.Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit me zbatimin e këtij vendimi.

9.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Kadri Hyska

